



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:037451
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05050385

C – IV. – 14 - 2299

Paditësi :

R S nga Kamenica.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lagja, "Lakrishtë" Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.12.12.2023, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procesi gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së paditësit, R S nga Kamenica.

II. Procedura e ndërprerë mund të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore të paditësit ose përfaqësuesi i ri ligjor, e marrin përsipër procedurën.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi, me dt.02.04.2014, përmes dërgimit me postë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), ka parashtruar kërkesë për rishikimin kundër Vendimit, GJI045

- 0150 i dt.05.03.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,800.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore, NSH “XIQ Karaqeva” me seli në Kamenicë (në likuidim) dhe se në arsyetimin e këtij Vendimi, AL-ja, është bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar sepse kërkesa e paditësit është bërë pas kalimit të afatit 3 vjeçar pasi kërkesa e paditësit ka të bëjë me kërkesën nga marrëdhënia e punës, se e drejta e paditësit për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ka lindur në muajin qershor 2008, në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit, Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), se në bazë të dispozitave të mësipërme për të ndërprerë afatin e parashkrimit, kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo në ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur parashtruesit e këtij paditësit, i lindi e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, pra tre vite nga muaji qershor 2008 e më gjerësisht si në arsyetimin e Vendimit të kundërshtuar të AL-së.

Pala paditëse e ka titulluar parashtrësën si “*Kërkesë për shikimin e vendimit*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në këtë padi/kërkesë, ka theksuar se me pranimin e njoftimit se GJI045, NSH, “XIQ Karaqeva” me seli në Kamenicë, se likuidimi i ndërmarrjes ka filluar më 09 dhjetor 2013 në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të dt.31 tetor 2013, se paditësi, si punëtor i saj, dhe ai si përfitues i 20 % -it, ka bërë këtë kërkesë ndaj ndërmarrjes në fjalë - dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, se në bazë të Ligjit të Punës, neni 76 i këtij ligji, rregullon ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, i cili parasheh edhe këtë dëmshpërblim (kompensimi) material të viteve të shërbimit në punë, se neni 76 pika 7.4 për 10 vitet përvojë pune, parasheh gjashtë (6) paga mujore, të llogaritur $6 \times 300.00 = 1,800.00$ €, se me 15 gusht 2006 nga AKM-ja – Zyra Regjionale në Gjilan, ka marrë njoftimin zyrtar se punësimi i tij përfundon menjëherë, se në të njëjtën letër, shkruan se shuma – pagat që i janë borxh atij sipas kontratës tuaj të punësimit, mbesin përgjegjësi, e punëdhënësit, se kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit, dhe se ai do të njoftohet kur të fillojnë këto procedura, se me këtë përshkrim AKM-ja, atë e ka lënë në pritje që kërkesa e tij do të shqyrtohet në procesin e likuidimit, se nuk i është përshkruar kurrfarë këshille juridike për pa afatshmërinë sipas kufizimeve kohore të aplikueshme sipas Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në ose sipas Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, se do të jenë të parashkruara për tri vjet, prandaj atë si dhe të tjerët, me njoftimin e 15 gushtit 2006, AKM-ja, ata i ka vënë në lajthitje pa fajin e tyre, e ka kërkuar nga gjykata që të anulohet Vendimi me nr. të kërkesës, GJI 045 - 0150 e të bëhet e mundur pagesa e pagave në bazë të Ligjit, Nr.03/L –212 e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi kësaj kërkesë për rishikim të Vendimit, ia ka bashkangjitur provat siç janë : kopja e Vendimit të AL-së, GJI045 - 0150 i dt.05.03.2014 , dhe kopjen e Njoftimit të dt.15 gusht 2006 të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), Zyra Regjionale në Gjilan për përfundimin e punësimit të paditësit në ndërmarrjen Shoqërore, NSH “XIQ Karaqeva” me seli në Kamenicë (në likuidim).

Me dt.28.03.2023, e paditura ka paraqitur mbrojtjen në padinë e paditëses e në të cilën ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga paditësit, se AL-ja, duke e refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e paditësit, është bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, e ka refuzuar si të pa vlefshme sepse aty, parashihet se : *''elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: 2.1.kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme''*, se sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, Nr,53 të viti 1976, i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.199/24, parashikon se : *''pagesa e shumës së pagës apo rrogës .. apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkuar për tre vjet''*, se objekt i kësaj procedure gjyqësore, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin, Nr.04/L – 034) e vendimit të AL-së, se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034, është shkelur nga AL-ja në marrjen e vendimit, andaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitat ligjore të Ligjit, 04/L-034, prandaj nuk ka bazë ligjore për të sh'fuqizuar Vendimin, se në bazë të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja, pretendohet të mos ketë paguara obligimet e saj ndaj parashtruesit – paditësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra më së voni tre vite nga 15 gushti i viti 2006, dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit, Nr.06/086 dhe se kësaj Mbrojtjeje si provë i ka bashkangjitur: kopjen e Vendimit të AL-së, GJI045 – 0150 të dt.05.03.2014 dhe Vendimin e AKP-së për emërimin e antarëve të Autoritetit të Likuidimit për NSH "XIQ Karaqeva" me seli në Kamenicë .

Me Urdhrin e saj, C - IV. – 14 - 2299 të dt.29.03.2023, kjo gjykatë, ia ka dërguar paditësit Mbrojtjen e të paditurës me mundësinë e paraqitjes së Përgjigjjes në mbrojtje dhe se pas ky dërgim nuk ka mundur t'i dërgohet paditësit për shkak të shkruarjes gabimisht të adresës së tij derisa me Urdhrin tjetër të saj, C – IV. – 14 - 2299 të dt.02.10.2020, kjo gjykatë, sërish ia ka dërguar paditësit Mbrojtjen e të paditurës, AKP-së me mundësinë e paraqitjes së Përgjigjjes në mbrojtje dhe se paditësit, R S nga Kamenica mirëpo sipas konstatimit të dt.16.11.2023 të postierit të postës lokale, është konstatuar se : *''marrësi është i vdekur''* pra paditësi, R S nga Kamenica, ka vdekur.

Me dt.22.11.2023, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare, me shkresën e saj, C - IV. – 14 – 2299 të dt.22.11.2023, i është drejtuar Komunës së Kamenicës – Drejtorisë për Administratë - Sektorit të ofiqarisë për sigurimin e të dhënave për paditësin, R S nga Kamenica, pra që të sigurojnë, dëshminë – provën gjegjëse (certifikatën e vdekjes etj) të paditësit, R S nga Kamenica, Lagjja, ''I'' pa nr. në Kamenicë e në mënyrë që gjykata të mund të procedoj më tej në këtë çështje juridike kontestimore.

Me dt.05.12.2023, Komuna e Kamenicës, përmes Përgjigjjes së saj, Nr.03 të dt.29.11.2023, e ka njoftuar gjykatën se me emrin e njëjtë, ekzistojnë më shumë se një person, dhe se për këtë arsye, edhe nuk mund të sigurojnë të dhëna të sakta.

Arsyetimi ligjor:

Procesi gjyqësor në këtë çështje juridike, duhet të ndërpritet dhe atë për shkak të vdekjes së paditësit, R S nga Kamenica.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1. pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGSJK), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj i veçantë.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme dhe se kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Po ashtu në nenin 277 par.1 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se: *“Procesi gjyqësor, ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale”*. Pastaj me nenin 280 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet gjykata i thërret palët”* derisa në nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se: *“Neni 280 i ligjit bazik, paragrafi 4, togfjalëshi “me propozimin e palës” fshihet nga teksti i ligjit”*. Duke qenë se në rastin konkret, pasi që kjo gjykatë me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 2299 të dt.02.10.2023, mbrojtjen e të paditurës, AKP-së, i ka dërguar paditësit, R S nga Kamenica fillimisht me dt.03.10.2023 dhe se sipas konstatimit të dt.03.10.2023 të postierit të postës lokale, është konstatuar se: *“marrësi është i pa njohur në këtë adresë”* mirëpo pas tentimit të dërgimit të serishëm të Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 14 – 2299 të dt.29.03.2023, sipas konstatimit të dt.16.11.2023 të postierit të postës lokale, është konstatuar se paditësi, R S nga Kamenica, ka vdekur derisa Komuna e Kamenicës duke vepruar sipas shkresës së kësaj gjykate, C - IV. – 14 – 2299 të dt.22.11.2023 për sigurimin e të dhënave për paditësin, R S nga Kamenica, e ka njoftuar gjykatën me Përgjigjjes së saj, Nr.03 të dt.29.11.2023, se me emrin e njëjtë, ekzistojnë më shumë se një person, dhe se për këtë arsye, edhe nuk kanë mundur që të sigurojnë të dhëna të sakta, andaj edhe kjo gjykatë edhe përkundër kësaj përgjigjeje, sipas konstatimit të dt.03.10.2023 të postierit të postës lokale, ka vlerësuar se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet ligjore që procesin gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore, duhet t’a ndërpres dhe atë për shkak të vdekjes së paditësit, R S nga Kamenica.

Gjykata nuk i përjashton trashëgimtarët e paditësit që të marrin përsipër procedurën si dhe gjykata i udhëzon trashëgimtarët e paditësit që me rastin e propozimit të tyre mbi vazhdimin e procedurës, t’ia bashkangjesin edhe aktvendimin mbi trashëgiminë për të ndjerin, paditësin, R S nga Kamenica e me qëllim që t’a dëshmojnë legjitimitetin e tyre aktiv pranë kësaj gjykate në rast të bërjes së propozimit për vazhdimin e procedurës së ndërprerë për shkak të vdekjes së paditësit në këtë çështje juridike kontestimore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, 76 par.3 të Ligjit, Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të

Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 277 par.1 pika a) dhe nenit 280 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe nenit 19 të Ligjit Nr.04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2023:037451, 12.12.2023

Gjykatësi
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimi të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).